




Të mësojmë për **DEPOZITAT** dhe **KREDITË**



Media Union
Instituti për Studime dhe Asistencë Bankare
Shoqata e Bankave Shqiptare

KURSEJMË EDHE QINDARKËN

Me të ardhurat tona shpenzojmë për të blerë mallrat dhe shërbimet që na nevojiten. Blejmë ushqime, veshmbathje, blejmë libra dhe gazeta, paguajmë energjinë elektrike, ujin, gazin, paguajmë telefonin etj. Pasi bëjmë gjithë këto pagesa, në fund të muajit shohim nëse kanë mbetur më para për të shpenzuar. Nëse nuk mbetet asgjë, atëherë gjithçka është e thjeshtë. Por nëse ka mbetur diçka, atëherë duhet të marrim një vendim: t'i shpenzojmë apo t'i kursejmë.



Një botë pa kursime


Mendoni për një moment se çfarë do të ndodhte sikur askush të mos kursente asgjë. Në një botë pa kursime nuk do të mundeshit të bënit shpenzime të mëdha për ngjarje të rëndësishme të jetës suaj. Pa kursime nuk blen dot gjëra të veçanta që të pëlqejnë shumë. Pa kursime mund ta kesh vështirë të jetosh në rast se sëmuresh apo mbetesh i papunë.



Pa kursime
makinën shihe
vetëm në ëndërr



Pa kursime nuk
ka as pushime



Pa kursyer
mbetesh pa
varrosur



Kursejmë që të blejmë gjërat speciale që na pëlqejnë aq shumë. Kursejmë që të përballojmë rastet urgjente që na krijohen atëherë kur nuk i presim.

Çfarë do të thotë të kursesh?

Kur kursejmë, secili prej nesh heq dorë nga kryerja e shpenzimeve në këtë moment me qëllim që të ketë mundësi të shpenzojë në të ardhmen. Pra, duke kursyer ulim aftësinë për të shpenzuar sot duke rritur atë të ardhme.

Me paratë e kursyera këta njerëz do të realizojnë ëndërrat dhe dëshirat e tyre



Ç'mu desh që harxhova për akullore se tani më duhet të paguaj edhe palestrën



Çfarë duhet të kemi parasysh kur i investojmë kursimet?

Kur i investojmë kursimet duhet të kemi parasysh sigurinë e tyre, sa likuid është investimi dhe cili është fitimi i mundshëm prej tyre. Do të ishte shumë mirë që kursimet të ishin 100% të sigurta, tërësisht likuide dhe me fitim maksimal. Por një gjë e tillë nuk është e mundur. Nëse duam, për shembull, më shumë fitim, atëherë nuk mund të kemi kursime 100% të sigurta apo tërësisht likuide.

Prandaj, kur investojmë kursimet, duhet të kemi parasysh se çfarë ka më shumë vlerë për ne nga këta tre elementë. Pastaj mund të zgjedhim mënyrën më të mirë të investimit që i përshtatet preferencës sonë.

Kur zgjedhim një investim likuid, atëherë kjo do të thotë që ky investim mund të

kthehet shumë shpejt në para të gatshme (para në dorë ose cash). Shpejtësia me të cilën një investim konvertohet në cash, quhet shkallë likuiditeti. Shkallën më të lartë të likuiditetit e kanë paratë që mbahen në shtëpi, në sirtar apo poshtë dyshekut sepse ato janë para. Por kur i mbajmë kursimet në këtë mënyrë, atëherë nuk fitojmë prej tyre asgjë dhe as nuk i kemi të sigurta.

Po këto?!
Nuk qenkan
shtuar
fare...





E di që paratë nuk do t'i kem në dorë, por të paktën do të fitoj diçka



Tani nuk m'i vjedh kush paratë, se me to bleva një ishull

Kur i depozitohet kursimet në bankë, atëherë investimi është më pak likuid sepse nuk mund t'i tërheqësh paratë në çdo kohë. Por rritet fitimi që ne marrim prej këtij investimi në formën e interesit të fituar. Sa më afatgjatë të jetë depozitimi, aq më shumë interes paguhet për të. Një arsye është se sa më afatgjatë depozitimi, aq më pak likuid bëhet investimi. P.sh., norma e interesit që paguhet për llogarinë rrjedhëse është më e vogël se ajo që

paguhet për një depozitë më afat 1 vit sepse në rastin e parë paratë mund t'i lëvizësh nga llogaria në çdo kohë, ndërsa në rastin e dytë duhet të respektosh afatin.

Kur blejmë me kursimet prona të patundshme apo vepra arti, atëherë mundësia për t'i konvertuar në para është më e ulët. Investime të tilla nuk janë shumë likuide.

Kursimet janë të rëndësishme për ekonominë

Kursimet janë të rëndësishme për ekonominë shqiptare. Nëse nuk do të kurseheshin para, atëherë nuk do të kishte fonde në dispozicion për të blerë makineri, ndërtesa dhe të tjera pajisje të nevojshme për të zhvilluar ekonominë. Sepse për të ndërtuar, për të çelur një punishte apo fabrikë etj., duhen shumë para. Askush i vetëm nuk do të mund t'i kishte këto para, por ato duhet të merren hua. Dhe, që të merren hua, duhet që dikush tjetër të kursejë. Kursimet e të gjithë popullsisë mbliidhen nga bankat dhe institucione të tjera të specializuara dhe u jepen hua atyre që investojnë. Duke investuar krijohen vende pune, rriten të ardhurat dhe mirëqenia.




Tashmë e keni vendosur se çfarë do të bëni me të ardhurat tuaja.

KURSEJINI ATO!



MARRIM HUA

Hua marrim sa herë duhet të bëjmë blerje apo investime dhe nuk kemi në dispozicion para të mjaftueshme. Hua mund të marrin individët, bizneset, bankat dhe madje edhe qeveritë. Huatë mund të merren në institucione të ndryshme. Hua mund t'u merret të afërme ose shoqërisë. Individët dhe bizneset mund të marrin hua në banka apo në shoqëritë e kursim-kreditit. Bankat marrin hua tek njëra-tjetra. Qeveria merr hua tek banka qendrore ose tek publiku. Shtetet marrin hua tek shtete të tjera e kështu me radhë.




Ç'do të ndodhte nëse askush nuk do të jepte hua?

Nëse askush nuk do të donte të jepte hua, atëherë shumë plane për investime apo ndërtime të rëndësishme do të mbeteshin të parealizuara. Mjaft të tjerë nuk do të kishin mundësi për të blerë banesa, pajisje shtëpish, automobila etj.

Një pjesë e nxënësve të shkollave të mesme mund të mos përfundonin shkollat e larta nëse nuk do të kishin mundësi të merrnin

hua etj., etj. Me pak fjalë, nuk do të zbatoheshin mijërat e projekteve të cilat ndihmojnë ekonominë për t'u zhvilluar.

Dhe nuk është e lehtë të kesh dhe të zhvillosh ide. Është akoma më e vështirë të kesh ide dhe para njëkohësisht. Prandaj përdoret huaja.



Bankat dhe institucionet e tjera ku mund të merret hua, ofrojnë lloje të ndryshme të tyre.

Huatë janë afatshkurtra ose afatgjata, në varësi të periudhës së kohës brenda së cilës duhet shlyer huaja.

Huatë jepen me garanci ose pa garanci; me shlyerje të njëhershme ose me shlyerje pjesore nëpërmjet kësteve; jepen për objekte të ndryshme si për të blerë ndërtesë, mjete xhiroje deri tek kartat e kreditit.




Çfarë duhet bërë që të merret një hua?


Duhet paraqitur në një bankë, fondacion apo shoqëri kursim-krediti kërkesa për të marrë hua. Përveç kësaj, banka ose çdo institucion tjetër do të kërkojë të plotësoni dokumente. Në këtë mënyrë banka vlerëson nëse jeni i përshtatshëm dhe i besueshëm për të marrë kredi. Kjo nënkupton që banka të të besojë se do t'ia ktheni përsëri dhe në kohë paratë e marra hua. Për këtë banka studion me kujdes këto tre elementë:

- Aftësinë (kapacitetin) për të shlyer huanë, dmth sa para të mbeten prej të ardhurave pasi janë kryer të gjitha shpenzimet.
- Garancinë e cila rrit sigurinë për kthimin e huasë dhe që përdoret në rast se nuk arrihet dot të shlyhet huaja.
- Karakteri si huamarrës i cili përcaktohet duke parë se sa i rregullt ke qenë me shlyerjen e huave të mëparshme. Me fjalë të tjera, ka shumë rëndësi historia në shlyerjen e kredive. Ç'ndodh nëse i drejtohesh bankës për herë të parë? Ka shumë mundësi të mos e marrësh huanë. Prandaj duhet të fillosh të krijosh

historinë si klient banke. Së pari, është mirë të çelësh një llogari kursimesh në bankë sepse në këtë rast bëhesh klient i bankës. Së dyti, mund të kërkoksh hua në shumë të vogël në bankë ose në ndonjë institucion tjetër dhe të përpiqesh të jesh i rregullt në shlyerjen e saj. Pas një përvoje të tillë rritet mundësia që banka të të japë hua.




Historiku i kreditit të klientit



Në rastet kur kërkesa për hua paraqitet nga një biznes, banka përveç kapacitetit, karakterit dhe garancisë, vlerëson edhe kapitalin dhe kushtet e huasë.

- Kapitali ka rëndësi të analizohet sepse tregon paratë që çdo pronar ka investuar në biznesin e tij, pra se sa keni rrezikuar në rast se biznesi falimenton. Banka ose çdo huadhënës tjetër krijon besim dhe jep huanë nëse keni investuar kapital të mjaftueshëm.
- Kushtet e huasë kanë të bëjnë me qëllimin e huasë. Banka analizon se për çfarë do të përdoren paratë e marra hua. Me fjalë të tjera, cili është objekti i huasë. Gjithashtu, analizohen edhe kushtet e mjedisit ekonomik të rajonit apo të vendit, ecuria e sektorit ekonomik të cilit i përket biznesi dhe bëhet vlerësimi se si e ndikojnë ato biznesin.



Plani i biznesit

Kur kërkon hua në një bankë, është e domosdoshme të përgatishni një paketë dokumentash në formën e një plani-biznesi (plani të aktivitetit). Ka shumë rëndësi që plani të jetë i plotë dhe i organizuar mirë. Një plan biznesi duhet të përfshijë këto kapituj:

- Të dhëna lidhur me emërtimin e biznesit, emrat e pronarit apo pronarëve, adresat dhe numrat e telefonit apo faksit.
- Një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së planit.
- Përshkrimin e kompanisë duke dhënë funksionet e saj, historinë e zhvillimit, produktet dhe shërbimet që ofron dhe tregjet ku punon.
- Analizën e tregut për produktin apo shërbimin tuaj, duke detajuar kërkesën që ekziston për to, konkurrentët tuaj, pengesat që keni për të hyrë në një treg dhe si keni menduar t'i kapërceni etj.
- Produktet dhe shërbimet të cilat përshkruhen në detaje.
- Veprimet ku përshkruhet se si bëhen produktet apo ofrohen shërbimet; ku e merrni lëndën e parë dhe materialet e tjera të nevojshme; si është i organizuar procesi i prodhimit (nëse jeni kompani që merreni me prodhime); cila është madhësia e fabrikës suaj, cilat janë fazat në të cilat kalon prodhimi etj..

- Plani i marketingut përshkruan gjithë planin e përgatitur për të shitur produktin ose shërbimin dhe grupet e klientëve të cilat synohen të afrohen. Gjithashtu, përfshihen planet për të organizuar reklamën, shpërndarjen e produktit etj.
- Pronësia. Në këtë kapitull tregohet se si është e organizuar nga pikëpamja ligjore kompania, struktura e pronësisë, roli i pronarëve në vendimmarrje etj.
- Drejtuesit dhe punonjësit. Jep një përmbledhje të të dhënave të çdo individi që ka rëndësi për ecurinë e biznesit.
- Fondet e kërkuara dhe përdorimi i tyre. Në këtë kapitull përshkruhen arsyet se përse nevojitet huaja dhe si do të përdoret ajo. Shuma e huasë së kërkuar, përfshi dokumentacionin për kolateralin apo dorëzanin. Plani i shlyerjes së huasë dhe plani i emergjencës në rast se plani fillestar nuk arrin të zbatohet.
- Pasqyrat financiare dhe parashikimi. Kanë të bëjnë me pasqyrat financiare personale, deklaratat e taksave dhe tatimeve dhe pasqyrat financiare të biznesit si bilanci, pasqyra e humbje-fitimit, analiza e fluksit të arkës për disa vite të kaluara dhe ecuria e parashikuar në të ardhmen.
- Shtojca dhe shembuj. Përshijnë informacion shtesë ose dokumentacion që përmendet në planin e biznesit, por që ka nevojë të jepet i detajuar.



MOS HARRONI INTERESIN

Thuhet që me para mund të blesh gjithçka. Por edhe paraja vetë ka një çmim. Pikërisht çmimi që paguhet për përdorimin e parave të një tjetri për një farë kohe, quhet interes.

Interesi që i paguhet dikujt, është

kompensimi që ai merr meqenëse ka hequr dorë përkohësisht nga aftësia për t'i shpenzuar paratë e tij. Pa interes pothuaj askush nuk do të ishte i gatshëm të jepte hua apo të depozitonte.



Përse paguhet interes?

Për huadhënësin interesi i paguar:

- kompenson rritjen e inflacionit ose të çmimeve me qëllim që të ruhet vlera reale e parave që janë dhënë hua;
- kompenson rrezikun e marrë përsipër

në rast se nuk kthehet huaja;

- kompenson, në rastin e një banke, kosto të tilla si përpunimin e dokumentacionit dhe sigurimin e fitimit të mjaftueshëm.



Kush ka më siguri,
kostumi apo
xhaketa e lëkurës



Interesi
është
çmimi i
parasë

Për huamarrësin interesi paguhet që të sigurohen:

- paratë e nevojshme për të shpenzuar aktualisht;
- paratë e nevojshme për të bërë menjëherë blerje të mëdha;
- paratë e nevojshme për të bërë investime të mëdha për të ardhmen si në arsim apo blerje ndërtesash a makinerish;
- paratë, në rastin e një banke, e nevojshme për t'u dhënë hua klientëve me qëllim që të sigurohet fitimi.



Interesi përfaqëson edhe kosto, edhe të ardhur. Interesi është e ardhur për deponituesit (huadhënësit) të cilët heqin dorë nga shpenzimi i parave të tyre për një

farë kohe. Interesi është kosto për huamarrësit. Duke ditur interesin çdokush mund të kuptojë se sa humbet nëse nuk i deponon paratë në banka.



Si llogaritet interesi?

Zakonisht, normat e interesit shprehen në përqindje vjetore (për një vit). Meqenëse shprehen në përqindje vjetore, është e lehtë të krahasohen normat e interesit për lloje të ndryshme huash apo depozitash ose për të njëjtat lloje nga një bankë në tjetrën.



Dua 100 mijë lekë borxh. Norma e interesit është 9% në vit. Borxhin e marr për një vit dhe në fund të tij do të kthej 109 mijë lekë. $(9:100 \times 100000 + 100000)$. 9 mijë lekët që paguaj më tepër është interesi, pasi përdora paratë e një tjetri

Kur interesi llogaritet vetëm mbi shumën e marrë hua ose të depozituar në fillim, quhet interesi i thjeshtë. Kur interesi llogaritet mbi shumën e marrë hua ose të depozituar në

fillim, por edhe mbi interesin e mëparshëm, quhet interesi i përbërë.

Jo! Në depozitë keni më shumë: Keni 153862 lekë sepse keni fituar interes edhe prej interesit të depozituar

Kam depozituar para 5 vitesh, 100 mijë lekë me 9% në vit. Dua të tërheq gjithë depozitën 109 mijë lekë.



Interesi i përbërë e rrit gjendjen e depozitave më shpejt se sa interesi i thjeshtë. Sa më e lartë norma e interesit, aq më shpejt rritet gjendja e depozitave si pasojë e llogaritjes së interesit mbi interes. Kini parasysh, që të arrini të keni të plotë këtë përfitim, nuk duhet të bëni tërheqje nga llogaria. Nëse keni depozituar një shumë parash në bankë dhe doni të dini me përafërsi se për sa vjet do të dyfishohet ajo, bëhet një llogaritje shumë e thjeshtë. Pjesëtohet numri 72 me normën e interesit të depozitës. P.sh., nëse norma e interesit është aktualisht 9% dhe depozitoni 100,000 lekë atëherë për 8 vjet gjendja e llogarisë suaj do të arrijë afërsisht 200,000 lekë.

Mos harroni, që kur tërhiqni interesat në bankë për paratë e depozituara, 10% do t'a paguani si tatim për Qeverinë.

Shumë banka, kur ju japin hua, përdorin atë që quhet "metodë e skontimit" në llogaritjen e interesit. Sipas kësaj metode interesi që duhet të paguajë huamarrësi, llogaritet dhe i mbahet qysh në fillim nga shuma e dhënë hua. Në këtë rast, norma reale e interesit të paguar për huanë është më e lartë se ajo që deklaron banka, pra kosto e huasë është më e madhe.

Secili nga personat e mëposhtëm ka marrë hua 120 mijë lekë për një vit.

Unë e mora huanë me 15% dhe interesin do ta paguaj në fund të vitit

Unë e mora huanë me 14% dhe e pagova interesin menjëherë



Ndërsa unë do paguaj vetëm 15%. Herë tjetër bëji mirë llogaritë



Niveli i normave të interesit

Norma e interesit është çmimi i parësë së dhënë ose të marrë hua. Prandaj niveli i saj përcaktohet në radhë të parë nga kërkesa dhe oferta për kredi e depozita. Për shembull, nëse rritet kërkesa për kredi, atëherë edhe çmimi i kredisë, dmth norma e interesit, rritet dhe e anasjellta. Kërkesa dhe oferta për kredi dhe depozita ndikohet nga tërësia e vendimeve që marrin bizneset dhe individët në lidhje me depozitat dhe huatë.



Kur depozitoni para në bankë rritet oferta për kreditë në ekonomi, sepse banka ka mundësi që të japë më shumë hua.

Qeveria Shqiptare shet Bono thesari




Kur blini një apartament dhe i keni marrë borxh bankës rrisni kërkesën për kredi në ekonomi

Kur blini Bono Thesari, rritet oferta për kredi në ekonomi, sepse i jepni borxh Qeverisë Shqiptare



Interesi përcaktohet edhe nga norma e inflacionit. Në fakt, një arsye se përse paguhet interesi, është inflacioni. Çdokush që depoziton paratë apo i jep ato hua për njëfarë kohe, kërkon të jetë i siguruar që kur t'i tërheqë nga banka apo kur t'i kthehet kredia, shuma të ketë të njëjtën

vlerë. Meqenëse çmimet rriten, atëherë për të ruajtur vlerën e kursimeve ndihmon interesi. Niveli i interesit duhet të jetë i tillë që të kompensojë rënien e vlerës së parësë ose të fuqisë blerëse për shkak të rritjes së çmimeve.



Normat e interesit dhe ekonomia

Niveli i normave të interesit ka një ndikim të konsiderueshëm në ekonomi.

Kur normat e interesit janë të ulëta, atëherë është më e lehtë për njerëzit të marrin hua për të blerë banesa, pajisje shtëpie, automobila. Duke u shtuar blerjet rritet kërkesa për prodhimin e pajisjeve dhe automobilitëve apo ndërtimin e banesave, rritet aktiviteti për shoqëritë që i tregtojnë apo firmat që i prodhojnë. Këto të fundit, për të përballuar kërkesat e rritura, investojnë më shumë në kapacitetin prodhues e ndërtues, hapin vende të reja pune dhe këto investime shpesh i financojnë duke marrë kredi nga bankat. Në këtë mënyrë, ekonomia zhvillohet.

Ndërkohë këto përfitime humbasin kur norma e interesit është e lartë. Një normë e lartë interesi nuk ndikon shumë tek niveli i depozitimeve. Nga njëra anë, depozituesit rrisin kursimet për të përfituar prej normës së lartë të interesit dhe nga ana tjetër, rritja e të ardhurave prej depozitave i bën ata të ndihen më të pasur, për pasojë të shpenzojnë më tepër.

Normat e interesit ndikojnë edhe vlerën e lekut. Nëse normat reale të interesit (dmth pasi është zbritur norma e inflacionit) janë më të larta në krahasim me vendet e tjera, atëherë rritet kërkesa për lekë duke e forcuar vlerën e tij.



Në çfarë monedhe t'i mbaj depozitat e mia

Ej shikoni!
Interesi i lartë të bën me krahe



KURSEJMË EDHE QINDARKËN ----- 2

Një botë pa kursime -----	3
Çfarë do të thotë të kursesh?-----	5
Çfarë duhet të kemi parasysh kur i investojmë kursimet?-----	6
Kursimet janë të rëndësishme për ekonominë -----	8

MARRIM HUA ----- 9

Ç'do të ndodhte nëse askush nuk do të jepte hua?-----	10
Çfarë duhet bërë që të merret një hua? -----	11
Plani i biznesit -----	13

MOS HARRONI INTERESIN ----- 14

Përse paguhet interes?-----	15
Si llogaritet interesi? -----	18
Niveli i normave të interesit -----	20
Normat e interesit dhe ekonomia -----	22



Financuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, OSFA (Soros)
Media Union
Instituti për Studime dhe Asistencë Bankare
Shoqata e Bankave Shqiptare

Design: ArtVizual Tel: 238 301
Vizatimet: Orlis Vathi
Realizimi grafik: Orest Muça

Tiranë 2004